



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

**INTERVISTË E KRYETARIT TË PREZENCËS SË OSBE-së, AMBASADORIT
BERND BORCHARDT, ME TELEVISIONIN “KLAN”**

31 tetor 2016

Intervistoi: Elja Zotka

TV Klan: Z. Ambasador, faleminderit që pranuat të zhvillojmë këtë intervistë së bashku. Pyetja e parë që do të doja t’ju drejtoja lidhet me komisionin e posaçëm të reformës zgjedhore. Është një komision që është ngritur prej afro një viti tashmë, por kemi parë që janë zhvilluar vetëm pak mbledhje. A mendoni se është koha e mjaftueshme deri në zhvillimin e zgjedhjeve, në qershor 2017, që ky komision të arrijë të përfshijë në ligjin elektoral të gjitha rekomandimet që OSBE/ODIHR-i ka bërë në zgjedhjet e 2013 dhe 2015?

Borchardt: Shumë faleminderit. Kanë mbetur edhe pak javë deri kur Presidenti, mbështetur në kuadrin ligjor, të dekretojë datën e zgjedhjeve të ardhshme dhe të fillojë procesi përgatitor i zgjedhjeve. Institucionet përgjegjëse, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, organet vendore, partitë, etj., kanë nevojë për kohë që të përgatiten dhe të njihen me sistemin. Deri tani rekomandimet e bëra nga OSBE/ODIHR-i – të cilat partitë e mëdha janë zotuar se do t’i zbatojnë – nuk janë zbatuar ende. Pra, ndiejmë presionin e kohës për kryerjen e ndryshimeve, në mënyrë që të gjithë të mund t’i fillojnë përgatitjet për zgjedhjet në terren të sigurt. Kështu që, ne e nxisim fuqimisht komisionin e posaçëm të punojë për këto çështje sa më shpejt të jetë e mundur.

TV Klan: Z. Ambasador, ju thoni që koha po shtrëngon dhe nuk ka shumë kohë që të bëhen rekomandimet që OSBE/ODIHR ka bërë për zgjedhjet në Shqipëri. Mendoni se mund të ketë kohë për të bërë një ndryshim të sistemit zgjedhor? Sepse, gjithmonë në prag zgjedhjesh, të gjitha partitë artikulojnë nevojën e ndryshimit të sistemit apo korrigjimit të tij.

Borchardt: Kjo çështje ka të bëjë me kohën në dispozicion dhe me shkallën e ndryshimeve. OSBE/ODIHR-i nuk sugjeron ndonjë sistem zgjedhor specifik. Unë jam gjerman dhe në Gjermani, për zgjedhjet kombëtare, rajonale dhe vendore ka të paktën 20 sisteme të ndryshme. Dhe gjithsecili prej tyre është legjitim dhe i është përshtatur traditës së rajonit. Pra, ne dhe OSBE/ODIHR-i e respektojmë plotësisht zgjedhjen e secilit vend për të zgjedhur sistemin zgjedhor më të përshtatshëm për të, për traditat dhe situatën e tij politike. Ajo që bëjmë ne është, nga njëra anë, këshillojmë se si t’i përshtatet teknikisht një sistem një situatë të caktuar, dhe, nga ana tjetër, rekomandojmë që procesi të shpejtohet, pasi institucionet zgjedhore, partitë e të tjerë duhet të njihen me sistemin.

TV Klan: Në rregull, ju jepni rekomandime, por a mund të na thoni, z. Ambasador, nuk e di nëse mund të jetë një rekomandim apo jo, a mund të bëjë Shqipëria zgjedhje me lista të hapura – po dëgjojmë nga partitë e vogla kryesisht që kërkojnë listat e hapura – dhe a mendoni se kjo do të mund të ishte një zgjidhje për përmirësimin e cilësisë të të zgjedhurve në parlament? Pasi gjatë gjithë këtyre tre viteve kemi dëgjuar shpesh të artikulohet çështja e dekriminalizimit, përfshirja e të inkriminuarve në parlament. A mund të ishte përzgjedhja e listave të hapura një zgjidhje për këtë çështje?

Borchardt: Vendimi për këtë është e drejtë ekskluzive e parlamentit shqiptar dhe, duke qenë se mund të prekë çështje që lidhen me Kushtetutën, do të nevojitej një shumicë e gjerë, pra do të duhej të gjendej konsensus. Ka argumente në favor të listave të hapura, ka argumente kundër listave të hapur dhe të gjitha këto argumente duhet të shqyrtohen me kujdes përpara se të merret vendimi. Ne dhe OSBE/ODIHR-i nuk themi “bëni këtë” apo “bëni atë”. Ne jemi të gatshëm të shpjegojmë pasojat e mundshme dhe kurthet teknike, që lidhen me modele të ndryshme.

TV Klan: E kuptoj, por në opinionin tuaj, a mund të bëhen në Shqipëri zgjedhje me lista të hapura? A do ta përmirësonte kjo cilësinë e të zgjedhurve tanë?

Borchardt: Unë nuk mund t’ju jap një mendim për këtë. Cilësia e parlamentit varet, ndër të tjera, nga listat që përpilojnë partitë politike dhe hartimi i listave është e drejtë e posaçme e partive. Pastaj, se për kë voton zgjedhësi mes kandidatëve në këto lista, varet nga zgjedhësi.

TV Klan: Dhe një tjetër pyetje, një propozim që vjen nga Partia Demokratike. Zoti Basha propozon që partitë politike, fushatat zgjedhore të financohen 100% nga buxheti i shtetit, sepse sipas tij në këtë mënyrë shmangim çdo lloj financimi të dyshimtë në zgjedhje që më pas mund të bëhet problem për korrupsion, për abuzime. A mendoni se është zgjidhje kjo në opinionin tuaj? A është zgjidhje financimi 100% i fushatave zgjedhore nga buxheti i shtetit?

Borchardt: Më lejoni, së pari, të shpreh vlerësimin tim për politikanët që kanë filluar të diskutojnë publikisht për financimin e zgjedhjeve. Në zgjedhjet e mëparshme, kur kam qenë ambasador i Gjermanisë këtu, kam parë së shifrat e publikuara dhe ajo ishte e dukshme në fushatat zgjedhore nuk përputheshin edhe aq shumë. Prandaj, është mirë që kjo temë ka dalë tashmë në planin publik dhe që po diskutohet. Nga ana tjetër, rregullimi i financimit të partive politike përbën një pjesë thelbësore të rregullimit të fushatave zgjedhore dhe vetë partive. Partive u nevojiten shumë para, jo vetëm për fushatat zgjedhore, por edhe për punën e tyre të përditshme dhe për përçimin e nismave dhe ideve të tyre elektoratit, edhe në periudhat jozgjedhore. Kjo kushton. Mund të bëhet vetëm me financim nga buxheti i shtetit, por duhen shumë para. A i ka shteti kaq para? Unë nuk e di. Mund të lejohet edhe financimi privat, gjë që lejohet në shumë vende. Ajo që është e rëndësishme për ne është transparenca e financimit, në mënyrë që të jetë shumë e qartë se kush jep para dhe sa para jep. Kështu zgjedhësi sheh se një parti financohet nga X, Y apo Z dhe, nëse atij nuk i pëlqejnë X apo Y, ky zgjedhës voton për dikë tjetër. Kjo është për ne çështja kryesore dhe në këtë pikë, mund të bëhen disa ndryshime të rëndësishme në Kodin Zgjedhor, në mënyrë që subjektet që marrin pjesë në zgjedhje të jenë të detyruara të japin informacione të hollësishme për burimin e parave që përpara zgjedhjeve. Po kështu, edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund të kontribuojë duke publikuar disa çmime reference, si për shembull sa kushton mesatarisht një poster, sa kushton një tubim, sa kushton një zyrë zgjedhore e partive. Më pas, qytetarët dhe shoqëria civile mund të krijojnë një ide sa kushton në të vërtetë një fushatë zgjedhore, ta gjykojnë vetë dhe ta kenë parasysh kur të bëjnë zgjedhjen e tyre në fletën e votimit. Një aspekt tjetër në këtë kontekst do të ishte fuqizimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në mënyrë që të ketë një rol më të fortë në mbikëqyrjen e transparencës së financimit të

fushatave zgjedhore. Për përmbushjen e këtij roli, KQZ-ja duhet të ketë edhe më shumë personel. Kjo do të ndihmonte dhe kjo është ajo çka ne sugjerojmë.

TV Klan: Duke qenë se ju, siç e thatë, keni qenë edhe Ambasadori i Gjermanisë në vendin tonë, riktheheni si Ambasadori i OSBE-së dhe pak a shumë e njihni politikën shqiptare, mentalitetin e politikanëve tanë dhe situatën në Shqipëri. A mendoni që mund të bëjë Shqipëria zgjedhje me standarde? A mund të jenë zgjedhjet e 2017-s zgjedhje që do të marrin një vlerësim të mirë nga OSBE/ODIHR-i?

Borchardt: Zgjedhjet janë përmirësuar ndër vite. Kjo është ajo çka ka rëndësi dhe ne do të bëjmë çmos që të kontribuojmë në mënyrë që këto zgjedhje të jenë më të mira.